

RELACION TEKNIK

Godina në të cilën ne si UKT sh.a operojme dhe ushtrijme aktivitetin, ne date 24.05.2022 është përfshirë nga zjarri në katin e parë të saj. Nga zjarri i rënë është dëmtuar kati i dytë dhe pjesërisht xhamat e kateve të tjera të godinës .

Punimet për kthimin në gjendje normale për punë të godinës konsistojnë në :

-Punime Ndërtimore të cilat përfshijnë zërat kryesor të tavaneve të gipseve , shtrim me pllaka në katin në të cilin ra zjarri, lysterjen e godinës në të cilat ka pasojë zjarri , rregullimin e vetratave etj.

Preventivat u hartuan sipas grupeve përkatëse referuar VKM 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" si dhe VKM Nr. 629 datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre

Pas rënies së zjarrit në ambientet e Ukt-sha është emergjente nderhyrja për të rikthyer ambientet në kushte punë që të kryhen punime elektrike. Materialet elektrike që do të përdoren duhet të jenë cilësore dhe termorezistente. Kabulli I bakrit I cili do të përdoret për linjat elektrike duhet të jetë me përcjellshmëri të lartë. Materialet elektrike të tilla si pincat rrjetit, Koka Rrjeti, Automat, Patch panel 24M, Patch panel 24M, prize, Kabuj rryme, Kuti shpërndarëse, shkarkues mbitembionit e të tjera si me poshtë janë të nevojshme për të bërë të mundur krijimin e rrjetit elektrik dhe rrjetit të internetit. Rrjetri elektrik dhe krijimi I posteve të punës për portat e internetit është i nevojshëm për të bërë gati postet e punës për punonjësit e UKT sha sa më parë, në mënyrë që të rikthehem në kushte normale punë. Ndricues led do të përdoren në tavan për ndricim sa më të mirë për të krijuar kushte të punës optimale për punonjësit e Ukt sha. Gjithashtu specifikimet teknike të kërkuara me poshtë janë parashikuar me materiale termoreziste.

Pas zjarrit në UKT sha, disa nga kondicionerët dhe rrjeti I cili bëjnë të mundur lidhjen midis elektromotorve të kondicionerve dhe njësive të brendshme janë djegur. Është e nevojshme që të kryhet konstatimi i dëmeve dhe me pas riparimi I kondicionerve të cilët e kanë të mundur venien në punë. Pas kryerjes së riparimit kondicionerët që do të konstatohen jashtë përdorimit, duhet të zëvendësohen me kondicioner të rinj. Kjo situatë është emergjente duke patur parasysh muajin në të cilin ka rënë zjarri dhe periudha e verës e bëjnë të pamundur punën në kushte normale pasi dhe godina është me vetrat xhami dhe temperaturat e brendshme në godinë arrijnë nivele maksimale nga efekti i sërë.